



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1010/15 Prot.

Tiranë, më 13.05. 2026

V E N D I M

Nr. 75 dt. 13.05. 2026

**“PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT MASTER NË
“STËRVITJE SPORTIVE DHE TË USHQYERIT” MIDIS UNIVERSITETIT TË
SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES DHE
UNIVERSITETIT EUROPIAN TË MADRIDIT”**

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7, 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, Vendimin nr. 78, datë 11.05.2026 të Rektoratit, Senati në mbledhjen e datës 13.05.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e marrëveshjes së programit të përbashkët Master në “Stërvitja Sportive dhe të Ushqyerit”, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe Universitetit European të Madridit (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.
3. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

